



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR
VETËVLERËSIMIN E STAFIT AKADEMIK

Dhjetor, 2023

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave.....	3
HYRJE.....	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC).....	4
Realizimi i pyetësorit.....	5
Gjetjet e pyetësorit.....	5
Rekomandimet.....	16

Lista e shkurtesave

IAL:	Institucion i Arsimit të Lartë
KQSCV:	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit
SEVC:	Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë
SMU:	Sistemi i Menaxhimit Universitar
UIBM:	Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë
ZSC:	Zyra për Sigurim të Cilësisë

Hyrje

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (këtu e tutje: UIBM), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë.

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin Dhjetor 2023, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UIBM, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UIBM, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësin për vetëvlerësimin e stafit akademik në UIBM, si një proces tashmë i zakonshëm. I gjithë procesi i lansimit të pyetësorëve dhe i mbledhjes së të dhënave është bërë nga ZSC-ja në koordinim të plotë me KQSCV-në. Procesi ka qenë transparent duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit. Më poshtë, do të paraqesim të dhënat që janë nxjerrë nga pyetësi. Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorit. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajnë edhe sugjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoratit të Universitetit “ISA BOLETINI” në Mitrovicë (tutje UIBM) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UIBM. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit

akademik të UIBM. Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UIBMsë. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.


Realizimi i pyetësorit

KQSCV ka aprovuar pyetësorin për vetëvlerësimin e stafit akademik dhe ZSC me datë 18.12.2023 deri më 24.12.2023 ka lansuar pyetësorin në SMU. Pyetësori ka qenë i destinuar për të gjithë profesorët dhe asistentët që kanë pasur lëndë aktive në semestrin dimëror 2023. Stafi Akademik është përgjigjur përmes SMU-së në pyetësorin i cili ka përmbajtur 32 pyetje të mbyllura dhe 3 pyetje të hapura, lidhur me kontributin e tyre në komunitet, përparësitë si dhe përmirësimet e nevojshme.

Gjetjet e pyetësorit

ZSC ka lansuar pyetësorin nga data datë 18.12.2023 deri më 24.12.2023 dhe kemi marrë gjithsej 62 vetëvlerësime të stafit akademik. Ky raport shprehë vetëm statistikën e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve.


1. Kam pasur probleme me qasjen online në ligjërata



2. Gjatë këtij semestri i kam realizuar pa asnjë problem temat e syllabusit




3. Përmes platformës SMU, kam kryer shërbimet si më poshtë:




4. Unë kam shpërndarë në javën e parë syllabusin e lëndës



5. Në ligjëratën e parë kam sqaruar përmbajtjen, vlerësimin, detyrat, literaturën etj.




6. Vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve për ndryshime në syllabus i kam marrë parasysh




7. Unë kam përdorë shembuj-raste nga praktika me qëllim që studenti ta kuptoj më mirë ligjëratën/ushtimet



8. Unë kam përdorë ndihmën e tabelave, teknologjisë, postereve e të ngjashme




9. Mësimin e kam zhvilluar
çdo javë sipas orarit




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht

10. Unë stimuloj interaktivitetin
me studentët




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht

11. Unë i kam përfshirë
hulumtimet e mia në
përmbajtjen e syllabusit




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht

12. Kam organizuar të paktën një
vizitë në
komunitet/shkollë/biznese/organi
zata etj.



■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht


13. Kam pasur të paktën një profesor/ekspert të ftuar në ligjeratat e secilës lëndë




14. Kam marrë pjesë të paktën në dy komisione pune në fakultet (komisione për mbrojtje të temave, komisione për hartim të dokumenteve, materialeve etj.




15. Marr pjesë në mënyrë aktive
në mbledhjet e Këshillit të
fakultetit



16. Kam kontribuar në procesin
e ri-akreditimit/akreditimit në
fakultet




17. Dorëzoj me kohë raportet e provimeve të studentëve




- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Pajtohem
- Pajtohem plotësisht

18. Qasja ime me studentët ka qenë gjithmonë korrekte




- Nuk pajtohem aspak
- Nuk pajtohem
- Pajtohem
- Pajtohem plotësisht

19. Çdo javë i zhvilloj konsultimet me studentët sipas orarit të publikuar në SMU/kabinet




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht

20. E kam respektuar formën e vlerësimit të studentëve sipas syllabusit




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht

21. Angazhimin e studentit nga
aktivitetet gjatë semestrit e
përfshij në vlerësimin
përfundimtar




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht

22. Marr parasysh sugjerimet e
studentëve për përmirësim të
zhvillimit të
ligjëratave/ushtrimeve




■ Nuk pajtohem aspak
■ Nuk pajtohem
■ Pajtohem
■ Pajtohem plotësisht


23. Unë kam bashkëpunuar me kolegët dhe me zyrën e IT-së për të eliminuar vështirësitë e shfrytëzimit të platformës online




24. Bashkëpunoj me kolegët tjerë për të identifikuar problemet e mësimit dhe të fakultetit




25. Kam marrë pjesë në trajnime
për metoda të reja të
mësimdhënies




26. Kam marrë pjesë në trajnime
të ndryshme




27. Unë vazhdimisht përmirësoj aftësitë në gjuhë të huaja




28. Gjatë këtij viti akademik, kam bërë një (apo më shumë) publikim në revistë shkencore




29. Gjatë këtij viti akademik,
kam marrë pjesë në një (apo më
shumë) konferencë shkencore




30. Gjatë këtij viti akademik
kam aplikuar për mobilitet



31. Këtë vit jam pjesë e një projekti ndërkombëtar



32. Gjatë këtij viti kam zhvilluar aktivitete që lidhen me kontributin në komunitet



33 Nëse keni zhvilluar aktivitete që lidhen me kontributin në komunitet, ju lutem tregoni ato:

Pyetje jo e detyrueshme.

Përgjigje e gjatë tekstuale (Paragraf teksti)

(19 përgjigje të postuara)

Disa nga aktivitetet e cekura nga stafi akademik:

- Organizimi i një eventit si aktivitet në kuader të HERE në lidhje me ndikimin e AI dhe AL dhe më gjërë.
- Organizimi i tryezës së rrumbullaket për barazi gjinore në Vushtrri.
- Organizimi i tryezës së diskutimit për shëndetin mendor-ndalimi I vetëvrasjeve.
- Projekte erasmus, cost, konferenca.
- Vizita në fakultete me nxënësit e shkollave të mesme.

34

Përparësitë e mia:

Pyetje e detyrueshme.

Përgjigje e gjatë tekstuale (Paragraf teksti)

(62 përgjigje të postuara)

Disa nga përparësitë e cekura nga vetëvlerësimi i stafit janë:

- Përdorimi i teknologjisë për vizualizimin e teorisë.
- Përqafimi dhe pëtshtatja me teknologjitë e reja në arsim.
- Bashkëpunues me stafin dhe studentët inovativ.
- Ofrimi I literaturës përkatëse adekuate në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Përvoja në sektorin e ICT.
- Gatishmëri për punë kërkimore sipas praktikave të vendeve perendimore

35

Nevoja për përmirësim:

Pyetje e detyrueshme.

Disa nga përmirësimet e nevojshme të cekura nga stafi janë:

- Metodologji të mësimdhënies
- Zgjerimi i horizontit të mësimdhënies duke përfshirë elemente ndërdisiplinore në edukim.
- Përmirsim i vazhdueshëm në gjuhë të huaja.
- Trajnime në mësimdhënie dhe teknologji.
- Më shume mobilitete dhe pjesëmarrje në rojekte.
- Përvetsimi i gjuhëve të huaja

Rekomandimet

Zyra e cilësisë e UIBM, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e vetëvlerësimit të stafit akademik, dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UIBMsë, që të merren hapat si më poshtë:

- Ofrimi i kurseve të gjuhëve të huaja për stafin akademik
- Përkrahja e stafit akademik në publikime shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Organizimi i trajnimeve për metodat e reja të mësimdhënies
- Krijimi i rrjetit të stafit akademik brenda UIBM për të ofruar mundësi të bashkëpunimit.
- Organizimi i vizitave studimore për stafin akademik dhe studentët.